



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 27.07.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.07.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik : **Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me material të shtypur “ , Nr. i prokurimit-632-20-5688-1-1-1, Nr. i brendshëm-632-20-091-111, nxjerr:**

V E N D I M

- I. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim Operatorit Ekonomik : **Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P**, e dt.19.07.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Furnizim me material të shtypur “ , Nr. i prokurimit- 632-20-5688-1-1-1, Nr. i brendshëm-632-20-091-111, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të , datës 14.07.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
- 2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES i publikuar me datë: 14.07.2021;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik : **Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P.**, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit **Furnizim me material të shtypur “ , Nr. i prokurimit- 632-20-5688-1-1-1, Nr. i brendshëm-632-20-091-111,**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 27.07.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues bazuar në Vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit, PSH.nr.149-155/21, ka kthyer lëndën në rivlerësim dhe ka vepruar sipas nenit 61, të LPP-së, për tenderë jo-normalisht të ulët, duke kërkuar nga Operatori ekonomik NSHT "ERPO-PRINT", sqarime shtesë më bindëse për çmimet e ofruara. Me dt.12.07.2021, Operatori ekonomik NSHT "ERPO-PRINT", ka ofruar sqarimet e kërkuara, të cilat për Autoritetin kontraktues kanë qenë bindëse dhe të mjaftueshme.

Tenderi juaj nuk është i suksesshëm për arsye se çmimi i juaj nuk është më i ulëti në mesin e tenderëve që plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara
Arkivit të Komunës

